

BASHKIA E TIRANES

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit ekonomik “HYDRO-ENG CONSULTING” shpk
Adresa: Rruga Ahmet Ramzoti, Lagjia Nr. 18, 2003 Durrës.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-98845-03-20-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti I:** “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi i korsive të dedikuara për autobus në disa akse rrugore, zgjidhja e nyjes Kastriotët dhe rehabilitimi i stacioneve autobus në zonën qendrore të Tiranës”.

Fondi limit: 1,101,646.97 (një milion e njëqind e një mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024, miratuar me VKB Nr.125, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024” (i ndryshuar).

Kohëzgjatja e kontratës: 9 (nëntë) muaj.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 02.04.2024, ora 10:00

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr.24 datë 13 Maj 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN” shpk
NUIS K71828007J

Vlera e ofertës = 914,871.39 (nëntëqind e katërmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një pikë tridhjetë e nëntë lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “HYDRO-ENG CONSULTING” shpk NUIS M11417503F

Vlera e ofertës = 953,037.70 (nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e shtatë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik "NOVATECH STUDIO" shpk **NUIS L01717030C**

Vlera e ofertës = **953,844.22** (nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzetë e katër pikë njëzet e dy) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik "TOWER" shpk **NUIS L21717003H**

Vlera e ofertës = **953,845.00** (nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik "G B Civil Engineering" shpk **NUIS L51825011V**

Vlera e ofertës = **953,859.62** (nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomik "ZENIT&CO & FTA Studio" shpk
NUIS K61731002D & L72411026N

Vlera e ofertës = **960,012.19** (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e dymbëdhjetë pikë nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

7. Bashkimi i operatorëve ekonomik "MAGNA CHARTA & HTS COMPANY" shpk
NUIS L92318021H & M11619018P

Vlera e ofertës = **960,779.09** (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë pike zero nëntë) lekë pa TVSH

8. Operatori ekonomik "A & E ENGINEERING" shpk **NUIS K72113010E**

Vlera e ofertës = **982,933.00** (nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik "INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" shpk

NUIS K71828007J

Arsyet:

Operatori ekonomik INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" shpk në shtojcën Nr.9 nuk ka deklaruar punonjësit sipas formatit të kërkuar si rrjedhojë nuk plotëson pikën 1/b të kriterëve të veçanta të kualifikimit përkatësisht pikën 4 dhe 5 të Kapacitetit teknik në DST ku citohet se: *Për stafin e kërkuar sipas pikës 4 dhe 5, operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument.*

Operatori ekonomik "INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN" shpk, nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuara në shtojca 8, Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta për kualifikim ku përcaktohet: *"Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 të APP "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", pasi vlera e ofertës është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi sipas VKM nr.354 date 11.05.2016 "Për miratimin e Manualit të Tarifave per Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim".*

Operatori ekonomik "TOWER" shpk

NUIS L21717003H

Arsyet:

Operatori ekonomik "TOWER" shpk ka deklaruar inxh.ndertimi, profili strukturor i cili nuk figuron ne licensen e shoqerise, çka në kundërshtim me pikën 4, te kapacitetit teknik të DST ku citohet se: *Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha sherbimeve te mbikqyrjes, të perfshirë në licensen e shoqerisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë ne listpagesat e shoqërisë per 3 muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.*

Operatori ekonomik "G B Civil Engineering" shpk

NUIS L51825011V

Arsyet:

Operatori ekonomik "G B Civil Engineering" shpk në Formularin e vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9, ka deklaruar punonjësit vetëm me emër mbiemër dhe profil punonjësish, çka bie në kundërshtim me pikën 4 dhe 5 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit ku citohet: *"Për stafin e kërkuar sipas pikës 4 operatorët ekonomik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojnë emër, mbiemër, profil i punës, numër, datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i diplomës/ kualifikimit, si dhe institucionin qe ka leshuar këtë dokument".*

Bashkimi i Operatoreve ekonomik "MAGNA CHARTA & HTS COMPANY" shpk

NUIS L92318021H & M11619018P

Arsyet:

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorëzuar në SPE, rezulton se operatori ekonomik HTS COMPANY nuk ka paraqitur pasqyrat financiare per vitin 2020 gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të DST, ku citohet se: Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020,2021,2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorëzuar në SPE, rezulton se Operatori ekonomik HTS COMPANY nuk ka paraqitur Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 6, germa d, të DST ku eshte citohet se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë: ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 39001-2012.

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorëzuar në SPE, rezulton se Operatori ekonomik HTS COMPANY nuk ka paraqitur Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020,2021,2022), gjë e cila bie në kundërshtim me pikën 2.2 germa b, Kapaciteti ekonomik dhe financiar të DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Operatorin ekonomik "HYDRO-ENG CONSULTING" shpk me adrese Rruga Ahmet Ramzoti,Lagjia Nr. 18,2003 Durrës, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 953,037.70 (nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e shtatë pikëe shtatë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkisë Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 953,844.22 (*nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzetë e katër pikë njëzet e dy*), siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____